



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**ZL.Anr.1123/2017**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Rafet Haxhaj, Nenad Lazic, Afijete Sada-Gllogjani, Zyhdi Haziri, Faton Ademi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkritazi me apelin e Fatmir Rashiti, kandidat i pavarur për Kryetarë Komune në Shtime, për shkak të mungesës së votave, pas Shpalljes së Rezultatit Përfundimtar, për raundin e dytë të Zgjedhjeve Lokale të mbajtura me 19.11.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 01.12.2017, mori këtë:

### **V E N D I M**

**Hudhet si i palejuar** apeli i Fatmir Rashiti, kandidat i pavarur për Kryetar Komune në Shtime, me shenjën ZL.Anr.1123/2017 e datës 30.11.2017, për shkak të mungesës së votave, pas Shpalljes së Rezultatit Përfundimtar, për raundin e dytë të Zgjedhjeve Lokale të mbajtura me 19.11.2017

### **A r s y e t i m**

PZAP, më datë 30.11.2017, ka pranuar apelin e parashtruar nga Fatmir Rashiti, kandidat i pavarur për Kryetarë Komune në Shtime, me të cilën pretendon se është dëmtuar në vota sepse është përdorur metoda e trenit Bullgar në këto Qendra të Votimit: 2201e/01R, 2201e/02R, 2201e/03R, 2201e/04R dhe 2201e/05R, 2207/01R dhe 2207/02D dhe është bërë presion tek votuesit. Në vendvotimin 2209e/01R votat e tij i janë bartur në formularë një kandidati tjetër. Kurse në vendvotimet 2204e/01R dhe 2204e/02D, është abuzuar me vullnetin e qytetarëve sepse ka blerë disa nga komisionerët e partive politike, dhe në dy këto vendvotime kanë votuar për njerëz të vdekur. Për të gjitha këto paregullësi dëshmitarët frikësohen për tu deklaruar për shkak të kërcënimeve dhe shantazheve. Andaj ka kërkuar që të përsëritet votimi në këto Qendra Votimi.

PZAP-i, pas shqyrtimit të lejueshmërisë së apelit, gjeti se:

**Apeli është i palejuar.**

Siç është e përcaktuar me LZP dhe me Rregulla Zgjedhore, secila fazë e procesit zgjedhorë, i ka afatet e caktuara ligjore, për të parashtruar ankesa dhe apele në PZAP, që ndërlihen me

fazën e procesit zgjedhor, që është duke u zhvilluar. Në këtë rast konkret, tani jemi në fazën e procesit zgjedhor, pas publikimit të rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve lokale për raundin e dytë, të mbajtura me datë 19.11.2017, për Kryetar të Komunave.

Paneli vlerëson se kjo fazë e procesit zgjedhor, është e ankimueshme vetëm sa i përketë vendimit të KQZ-së për shpalljen e rezultatit përfundimtar, për kryetar të Komunave dhe atë për parregullsitë e shkaktuara gjatë administrimit të të dhënave në QNR, mospërputhjet e FPR-ve, FRK-ve, dhe provave që eventualisht i sjell pala që ka interes ligjor, e të cilat prova nuk përputhen me rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve, apo parregullsitë të cilat kanë qenë të ditura publikisht dhe që janë konsideruar nga paneli se mund të kenë ndikim drejtpërdrejt në rezultat final dhe që minojnë procesin zgjedhor, por nuk janë përmirësuar respektivisht nuk janë eliminuar nga KQZ-ja, edhe pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, siç është rasti i Parteshit, i vendosur nga PZAP-i, për parregullsitë për ditën e votimit me vendimin ZL.Anr.447/2017 i datës 25.10.2017 dhe vendimi i PZAP-it, për të njëjtën komunë, i vendosur pas shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, për kryetar të kësaj Komune, ZL.Anr.560/17 i datës 02.11.2017, dhe i vërtetuar me vendimin e Gjykatës Supreme U.ZH.-A.A.nr.28/2017 i datës 06.11.2017.

Me nenin 106.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme i cili përcakton se: *“KQZ-ja certifikon rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve, pas përfundimit të të gjitha procedurave në vendvotime dhe në qendrat e numërimit si dhe kur të gjitha vërejtjet e dala që u përkasin votimit dhe numërimit janë vendosur nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia dhe nga Gjykata Supreme e Kosovës”*. Në momentin kur certifikohen rezultatet përfundimtare nga KQZ-ja, të gjitha ankesat dhe apelet e kësaj natyre janë të përfunduara.

Pretendimet ankimore të parashtruara në apel nga Fatmir Rashiti, kandidat i pavarur për Kryetarë Komune në Shtime, i referohen parregullsive, në ditën e votimit për raundin e dytë të zgjedhjeve lokale të mbajtura me datë 19.11.2017, se subjekti politik i certifikuar ka përdorur metodën e trenit Bullgar në Qendra të Votimit, është bërë presion tek votuesit, është abuzuar me vullnetin e qytetarëve sepse ka blerë disa nga komisionerët e partive politike, dhe kanë votuar për njerëz të vdekur, janë pretendime të cilat në këtë fazë të procesit zgjedhor paneli i vlerëson si të paluejshme, sepse për të gjitha parregullsitë që ndërlidhen me ditën e votimit, afati për të parashtruar ankesë në PZAP, ka qenë 24 orë nga mbyllja e Qendrave të Votimit, në këtë rast afati për të parashtruar ankesë në PZAP, ka qenë deri me datë 20.11.2017, në ora 19:00.

Nga se dispozita ligjore e nenit 119 par.1 të LZP-së me Nr.03/L-073, i ndryshuar dhe i plotësuar me LIGJIN Nr. 03/L-256, përcakton se: *“Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të paraqesë ankesë PZAP-it brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit, dhe PZAP-i do të vendos për ankesën brenda 72 orëve nga koha kur është pranuar ankesa”*.

Paneli apelin e parashtruar nga Fatmir Rashiti kandidat për kryetarë për Kuvendin Komunal në Shtime, e hodhi si të palejuar në bazë të dispozitës së nenit 11.5 të Rregullores Nr.02/2015 për Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, ku është përcaktuar se: “Apelet të cilat janë të palejuara dhe të pasafatëshme PZAP-i i i hudhë poshtë me vendim”.

Prandaj nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 106.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, nenit 118 par.1 të LZP-së, si dhe nenit 11 par.5 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

Anr.1123/2017 më datën 01.12.2017.



**Kryesuese e Panelit**

**Gyltene Sylejmani**

***Këshillë Juridike:*** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.